



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18 maj 2026
Kodi i ZRRE-së V_3238_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në dispozitat e Nenit 9, Nenin 16, Nenin 25, Nenin 54 par. 1 nënpar. 1.1, Nenin 55, Nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe Nenin 57 par. 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 7, Nenin 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, dispozitat ligjore të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike, Nenin 3, Nenin 4, Nenit 5, Nenin 7 dhe Nenin 8 dhe Nenin 9 par. 6 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, dhe Nenin 23 të Licencës Nr. ZRRE/Li_17/17 për NH „Ibër Lepenc“ SH.A, Dispozitat e nenit 23 të Licencës për Prodhim të Energjisë Elektrike të lëshuar Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” SH.A.(HC UJMANI), Njoftimin Nr. 374/26 të datës 23 prill 2026 lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me referim të çështjes në ZRRE nga KOSTT SH.A. për jo-balancat e NH “Ibër Lepenc” SH.A. (HC “Ujmani”), Përgjigjet nga Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” SH.A.(HC UJMANI) të pranuar me datë 07.05.2026 nr. prot. 433/2026,

në seancën e mbajtur me 18 maj 2026 ka nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** - se Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A. – HC Ujmani, gjatë operimit në tregun e energjisë elektrike për periudhën e monitoruar, ka vepruar në mos-pajtueshmëri me nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 dhe 1.4 dhe nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nenin 11.1.9 të Rregullave të Tregut, si dhe me kushtet e Licencës për Prodhim të Energjisë Elektrike, lidhur me përgjegjësinë balancuese dhe respektimin e Rregullave të Tregut.
- II. **I VENDOSËT MASË ADMINISTRATIVE** - Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A. – HC Ujmani, për shkak të shkeljeve ligjore dhe rregullative të konstatuara sipas pikës I të këtij Vendimi.
- III. **OBLIGOHET** - Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A. – HC Ujmani që të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme operative, teknike dhe organizative për sigurimin e pajtueshmërisë ndërmjet nominimeve dhe realizimeve, respektimin e përgjegjësive balancuese dhe shmangien e përsëritjes së shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.
- IV. **OBLIGOHET** - Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A. – HC Ujmani që brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i këtij Vendimi të dorëzojë në ZRRE planin e masave korigjuese dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e nominimeve dhe devijimeve.



ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka zhvilluar procesin e monitorimit ndaj Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A., respektivisht HC Ujmani, lidhur me referimin e çështjes në ZRRE nga ana e KOSTT sh.a., për devijimet e vazhdueshme ndërmjet energjisë së nominuar dhe energjisë së realizuar gjatë periudhës së monitoruar.

ZRRE, pas pranimit të informatave dhe analizave nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a., ka zhvilluar monitorimin mbi pajtueshmërinë e veprimeve të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A. me dispozitat e legjislacionit primar, sekondar, Rregullave të Tregut dhe kushteve të Licencës për Prodhim të Energjisë Elektrike.

ZRRE gjatë procesit të monitorimit, ka analizuar të dhënat operative dhe raportet e nominimeve dhe realizimeve të energjisë elektrike, nga të cilat është konstatuar se HC Ujmani ka shkaktuar devijime të vazhdueshme dhe në raste të caktuara shumëfish më të larta se nominimet e paraqitura tek Operatori i Sistemit, pa reflektuar përshtatje adekuate të nominimeve në raport me realizimet faktike të prodhimit.

ZRRE, në vazhdim të procesit të monitorimit, ka përgatitur Raportin Fillestar të Monitorimit lidhur me referimin e çështjes në ZRRE nga ana e KOSTT për jo-balancet e NH "Ibër Lepenc" Sh.A., i cili në mbledhjen e mbajtur me datë 03 maj dhe 13 maj 2024, është shqyrtuar nga Bordi i ZRRE-së, në pajtim me Nenin 7 paragrafi 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, dhe i është dërguar të licencuarit për komente dhe përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor.

Gjatë afatit procedural, NH "Ibër Lepenc" Sh.A., përmes emailit të datës 30.05.2024 dhe shkresës Nr. 02-1917, ka kërkuar shtyrje të afatit për paraqitjen e komenteve lidhur me raportin fillestar të monitorimit edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë. Pas shqyrtimit të kërkesës, Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se kërkesa për shtyrje të afatit është e arsyeshme dhe e pranueshme.

ZRRE, me datë 19.06.2024 nr. prot. 368/24, ka pranuar komentet dhe përgjigjet nga NH "Ibër Lepenc" Sh.A. lidhur me raportin fillestar të monitorimit, të cilat janë analizuar dhe vlerësuar me kujdes nga ZRRE.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të komenteve dhe përgjigjeve të NH "Ibër Lepenc" Sh.A. lidhur me raportin fillestar të monitorimit, ZRRE ka vlerësuar se pala nuk ka arritur të kundërshtojë të gjeturat faktike dhe juridike të konstatuara gjatë monitorimit. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 57 par. 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE me datë 23.04.2026 ka nxjerrë Njoftimin Nr. 374/26 lidhur me mos-pajtueshmëritë e konstatuara në lidhje me referimin e çështjes në ZRRE nga ana e KOSTT sh.a., për jo-balancet e NH "Ibër Lepenc" Sh.A. – HC Ujmani.

ZRRE me datë 07.05.2026 nr. 433/26 ka pranuar përgjigjet me shkrim nga NH "Ibër Lepenc" Sh.A. – HC Ujmani ndaj Njoftimit për mos-pajtueshmëritë e konstatuara, përmes të cilave pala ka paraqitur arsyetimet dhe pretendimet e saj lidhur me devijimet e evidentuara gjatë periudhës së monitoruar.



ZRRE, me rastin e vlerësimit të pretendimeve, ka marrë parasysh me kujdes rrethanat specifike të periudhës së monitoruar, përfshirë krizën energjetike, situatën operative në veri të Republikës së Kosovës dhe vështirësitë e pretenduara nga pala në koordinimin operacional të HC Ujmani. Megjithatë, ka vlerësuar se asnjë nga këto rrethana nuk e përjashton të licencuarin nga obligimi ligjor dhe rregullator për të respektuar Rregullat e Tregut, kushtet e Licencës dhe përgjegjësitë balancuese të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

ZRRE vlerëson se, në përputhje me nenin 11.1.9 të Rregullave të Tregut, palët tregtare janë përgjegjëse të sigurojnë që injektimi dhe konsumi momental të jetë sa më afër vlerës së nominuar tek Operatori i Sistemit, dhe se devijimet mund të konsiderohen të pranueshme vetëm atëherë kur ato janë minimale, të arsyeshme dhe të menaxhuara në përputhje me kërkesat e tregut dhe përgjegjësisë balancuese.

Nga analiza e të dhënave operative dhe raporteve të monitorimit është konstatuar se devijimet e HC Ujmani nuk kanë qenë raste të izoluar apo të herë pas hershme, por kanë qenë në disa raste të vazhdueshme dhe në raste të caktuara shumëfish më të larta se nominimet e deklaruara, pa reflektuar përshtatje adekuate të nominimeve bazuar në realizimet paraprake të prodhimit. Për më tepër, ZRRE, vlerëson se pala, edhe pas reagimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme nga ZRRE dhe KOSTT, nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për eliminimin apo minimizimin e devijimeve të evidentuara gjatë periudhës së monitoruar.

ZRRE, po ashtu ka trajtuar me kujdes pretendimet e NH "Ibër Lepenc" Sh.A. se devijimet e prodhimit kanë kontribuar pozitivisht në stabilitetin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës gjatë periudhës së krizës energjetike. Në këtë situatë, ZRRE vlerëson se edhe në rastet kur devijimet mund të kenë pasur efekt pozitiv në periudha të caktuara operative, kjo nuk e eliminon përgjegjësinë e të licencuarit për respektimin e obligimeve ligjore dhe rregullative që rrjedhin nga Rregullat e Tregut dhe Licenca.

ZRRE, vlerëson se balancimi i sistemit elektroenergjetik është kompetencë ekskluzive e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a., dhe palët tregtare nuk mund të vet- vlerësojnë ndikimin e devijimeve të tyre në sistem apo të justifikojnë mospërputhjet ndërmjet nominimeve dhe realizimeve me pretendimin se të njëjtat kanë ndikuar pozitivisht në stabilitetin e sistemit.

ZRRE, gjithashtu ka vlerësuar pretendimet e NH "Ibër Lepenc" Sh.A. lidhur me barrierat politike, situatën në veri të Republikës së Kosovës dhe funksionalizimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike përmes ALPEX-it. Megjithatë, vlerëson se këto pretendime nuk ndryshojnë përgjegjësitë ligjore të të licencuarit dhe nuk paraqesin bazë juridike për përjashtim nga zbatimi i dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullave të Tregut dhe kushteve të Licencës.

ZRRE, vlerëson se pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike dhe përgjegjësia balancuese përbëjnë elemente themelore për funksionimin transparent, të sigurt dhe të parashikueshëm të tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, dhe çdo devijim i vazhdueshëm ndërmjet nominimeve dhe realizimeve cenon integritetin e mekanizmave të tregut dhe sigurinë operative të sistemit elektroenergjetik.



ZRRE, vlerëson se respektimi i nominimeve dhe minimizimi i devijimeve përbëjnë elemente thelbësore për funksionimin e sigurt, transparent dhe të parashikueshëm të tregut të energjisë elektrike. Mosrespektimi i këtyre obligimeve ndikon drejtpërdrejt në planifikimin operacional të sistemit, në mekanizmat e balancimit dhe në sigurinë e operimit të tregut, për çka subjektet e licencuara janë të obliguara të veprojnë me kujdes të shtuar dhe në pajtim të plotë me kërkesat rregullative dhe teknike në fuqi.

Vlen të theksohet se gjatë procesit administrativ ZRRE, ka shqyrtuar edhe sqarimet dhe vlerësimet e paraqitura nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a., lidhur me operimin e HC Ujmani gjatë periudhës së monitoruar, përfshirë edhe ndikimin e rrethanave operative dhe krizës energjetike në sistemin elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, KOSTT ka theksuar se gjatë periudhave të caktuara operative, prodhimi i HC Ujmani ka kontribuar në stabilitetin e sistemit elektroenergjetik dhe se devijimet e evidentuara nuk janë vlerësuar si veprime me karakter manipulues apo qëllim të dëmtimit të sistemit.

Megjithatë, ZRRE vlerëson se këto sqarime dhe vlerësime operative të paraqitura nga KOSTT nuk e përjashtojnë as KOSTI-in, e as të licencuarin nga obligimet ligjore dhe rregullative që dalin nga Ligji për Energjinë Elektrike, Rregullat e Tregut dhe kushtet e Licencës. Për më tepër, përgjegjësia për balancim dhe respektimi i nominimeve përbëjnë obligime të vazhdueshme të secilës palë tregtare dhe nuk mund të zëvendësohen me vlerësime operative mbi ndikimin eventual të devijimeve në sistem.

Po ashtu, ZRRE, me rastin e vlerësimit të proporcionalitetit të masës administrative, ka marrë parasysh edhe faktin se gjatë procesit të monitorimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit administrativ nuk është konstatuar apo provuar se veprimet e HC Ujmani kanë shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë publik, përfitim të kundërligjshëm apo cenim konkret financiar ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike. Megjithatë, mungesa e një dëmi konkret të provuar nuk e eliminon përgjegjësinë e të licencuarit për respektimin e obligimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, Rregullat e Tregut dhe kushtet e Licencës.

ZRRE gjatë gjithë procesit administrativ i ka garantuar palës të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur komentet, provat dhe arsyetimet e saj lidhur me të gjeturat e raportit të monitorimit dhe njoftimin për shkelje, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar me kujdes nga Bordi i ZRRE-së, para marrjes së këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së, me rastin e vendosjes së masës administrative, ka marrë parasysh edhe faktorët lehtësues të përcaktuar me Nenin 6 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, duke vlerësuar: a) rrethanat specifike operative gjatë periudhës së krizës energjetike; b) mungesën e provuar të qëllimit manipulues apo përfitimit të kundërligjshëm në treg; c) bashkëpunimin procedural të palës gjatë procesit të monitorimit; si dhe d) faktin se pala pas funksionalizimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike ka ndër marrë hapa për përmirësimin e operimit dhe pjesëmarrjes në treg.

Prandaj, Bordi i ZRRE-së, vlerëson se qëllimi i këtij vendimi nuk është ndëshkimi material i të licencuarit, por siguri i pajtueshmërisë rregullative, ruajtja e integritetit të tregut dhe parandalimi i



përsëritjes së shkeljeve të ngjashme në të ardhmen. Duke u bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, Bordi ka vlerësuar se vendosja e masës administrative paraqet masë të drejtë, proporcionale dhe të mjaftueshme për arritjen e qëllimit rregullator dhe mbrojtjen e interesit publik.

Vendimi për vendosjen e masës administrative është marr konform dispozitave ligjore të Nenit 57 par. 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Nenit 6 dhe Nenit 8 par. 1.1., 1.3 dhe 1.4 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat të nxjerr nga ZRRE.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fejzullahu, Kryesues




Lutfije Dervishi, anëtar



Gani Buçaj, anëtar



Arta Isufi, anëtar



Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.